Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

24. Konvertimi në valutë të vetme

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

G. DHËNIA E KONTRATËS

25.Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

H. ANKESAT

27. Procedura ankesës

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

I. ANULIMI I PROCEDURËS

28. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje
- Shtojca 2: Ftesa për Propozim
- Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
- Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
- Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
- Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
- Shtojca 11: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
- Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 1

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

KËRKESË PËR PJESËMARRJE

(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 2

[Shtojcë për t’u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor]

FTESË PËR PROPOZIM

(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)

[Data]

Për : [Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]

Procedura e Prokurimit: _____

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se [emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur], pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e pare, jeni kualifikuar për në fazën e e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë _____ (emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :

Data, ora dhe adresa

Data: □□/□□/□□□□(d/m/v) ora □□:□□

Adresa: _____

Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.

Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:

Shqip

Anglisht

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 3

[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].

- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE] në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.

- (d) Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.

- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

e) Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Datë

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 4

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik*]

FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK

Tarifat sipas Kategorisë së Punës : (Nëntotali i detajuar)

Pagesat Ditore: (Nëntotali i detajuar)

Kostot e Drejtpërdrejta: (Nëntotali i detajuar)

Shpenzimet e Rimbursueshme: (Nëntotali i detajuar)

TOTALI

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 5

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 6

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË **Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit²**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, **me asnjë** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

² Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

Shtojca 8

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 9

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Afatet e ekzekutimit:

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3
1	Mbedhja e dokumentacionit (të dhenave) mbi sha-t	x		
2	Analiza ligjore, financiare		x	
3	Përgatitja e akteve ligjore, dokumentimi i procesit, Raporti final		x	x

Shërbimi do të realizohet brenda 3 (tre) muajve duke nisur nga data e nënshkrimit të kontratës.

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”**

Pasqyrë e Përgjithshme

Rezidenca studentore Nr. 1 sh.a është themeluar në datë 26.05.2005 me NIPT K51814005N. Selia e saj ndodhet në Qyteti Studenti, Tirane. Ajo ka për objekt trajtimin në fjetore dhe menca të studentëve të Universitetit Tiranë. Rezidenca ofron prodhim dhe furnizim me avull për ngrohje të të gjitha ambjenteve të ndërmarrjes dhe për të tretë. Furnizimi me ujë të pijshëm dhe largimi i ujrave të përdorura të Qytetit Studenti. Pastrim, gjelberim dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme të Qytetit Studenti. Krijimi i kushteve për veprimtari kulturore e sportive, salla leximi e dëfrimi dhe ambjente çlodhëse. Shërbim bibliotekar dhe social për studentët. Veprimtari të tjera shërbimi nëpërmjet dhënies me qira të ambjenteve subjekteve të ndryshme për shërbime private.

Në muajin korrik 2020 ka përfunduar riorganizimi i “Rezidenca Studentore Nr. 1” sh.a në të cilin është bashkuar edhe “Trajtimi i Studentëve Nr. 3” sh.a, dhe u morë përsipër me gjithë të drejtat dhe detyrimet sipas pasqyrave financiare të vitit 2019

Rezidenca Studentore Nr. 2 sh.a është themeluar në datë 20.06.2005 me NIPT K51730022L. Selia e saj ndodhet në Tiranë. Ajo ka për objekt trajtimin e studentëve të Fakultetit të Inxhinjerisë së Ndërtimit, të Mjeksisë, Infermierisë dhe Akademisë së Fiskulturës me ushqim, fjetje dhe shërbime të tjera.

Me vendimin nr. 335, date 04.05.2016 të Këshillit Ministave “Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare “Rezidenca studentore nr. 1” sh.a., Tiranë, “Trajtimi i studentëve nr. 2” sh.a., Tiranë dhe “Trajtimi i studentëve nr. 3” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes të Bashkia Tiranë”, këto aksione janë transferuar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e saj në Bashkisë e Tiranës.

Objekti i angazhimit dhe organizimi i punës

Bashkia Tiranë synon të realizojë një shërbim vlerësimi financiar dhe konsulencë juridike, me qëllim riorganizimin e shoqërive aksionare me kapital publik si vijon:

1. Rezidenca Studentore Nr. 1 sh.a
2. Trajtimi i studentëve Nr. 2 sh.a (Ndryshuar në emërtim me “Rezidenca Studentore Nr. 2” sh.a).

Në mënyrë që Bashkia të ketë një informacion të plotë për 2 (dy) shoqëritë me kapital publik që janë objekt i këtij procesi vlerësimi, është i domosdoshëm organizimi i punës në dy komponentë:

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

- i. Financiar
- ii. Ligjor

Ne mënyrë më të detajuar raporti i vleresimit financiar dhe konsulencës juridike do të analizojë hollësisht aspektet që vijnë si më poshtë:

ANALIZA FINANCIARE

Përshkrim i shkurtër i shoqërive

- Një përmbledhje të historisë dhe zhvillimit të biznesit, duke theksuar ngjarjet kryesore dhe ndryshimet në drejtim;
- Kapitali aksionar dhe pronësia;
- Pasuritë, asetet dhe pronësia/administrimi i tyre;
- Struktura e shoqërive;
- Natyra e tanishme e biznesit, vendndodhjet dhe aktivitetet kryesore të biznesit.
- Do të analizohet performanca historike e biznesit të shoqërive me referenca tek pasqyrat financiare të tre viteve të fundit. Fokusi do të jetë në:
 - Analizën e qarkullimit, kontributin/fitimin bruto dhe EBITDA sipas llojit të të ardhurave dhe treguesit kryesorë të performancës;
 - Analizën e ndryshimeve në shpenzimet direkte dhe shpenzime të tjera që ndikojnë në marzhin bruto;
 - Analizën e shpenzimeve të përgjithshme/qëndrore/dhe të administratës;
 - Njëpërmjet diskutimit me drejtuesit, një përmbledhje të bazës së natyrës së kostos fikse, variabël dhe gjysëm variabël;
- Diskutime me drejtuesit për të identifikuar shërbime shtesë/kostot e tyre;
- Rakordimin e informacionit historik të fitim-humbjes të paraqitur në pasqyrat financiare dhe atij sipas llogarive të dhëna nga drejtuesit, me qëllim për të përpunuar pasqyrat e përgatitura nga drejtuesit, duke theksuar si të zbatueshme:
 - rregullime për ndarjet e fitimit;
 - rregullime për pasqyrat financiare të fund vitit;
 - rregullime për politikën e kontabilitetit;
 - rregullime për të reflektuar/përfshirë blerjet/shitjet; dhe
 - rregullime për monedhën.

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

- Politikat kryesore të kontabilitetit.

Tregtimi aktual dhe rezultati i parashikuar

Duke ju referuar llogarive të shoqërive do të analizohet performanca e veprimtarisë të tanishme të biznesit të shoqërive, duke u fokusuar në:

- Analizën krahasuese të veprimtarisë ekonomike, nga fillimi i vitit deri në datën e llogarive me të njëjtën periudhë, për vitin paraardhës;
- Analizë krahasuese e veprimtarisë ekonomike nga fillimi i vitit deri në datën e llogarive me atë të buxhetuar;
- Analizën e rezultateve të tregtimit të 12 muajve të fundit.

Fluksi monetar historik

Analizë e flukseve historike të parasë të biznesit të shoqërive duke i'u referuar pasqyrave financiare të tre viteve të fundit, duke u përqëndruar në:

- Rakordimin e fitimit operativ me flukset e parasë operative dhe analizën e elementeve kryesor;
- Analizën e shpenzimeve kapitale duke theksuar:
 - komentet në trendet historike dhe sezonale në shpenzimet kapitale në krahasim me nivelet e shpenzimeve të amortizimit dhe shpenzimeve të buxhetuara;
 - analizën e shpenzimeve kapitale midis shpenzimeve kapitale për zëvendësim/mirëmbajtje dhe për zgjerim/ rritje;
 - shitjet e rëndësishme të aktiveve fikse/ trendet në të ardhurat nga shitja e aktiveve fikse; dhe
 - komentet në vjetërsinë e aktiveve, daljen nga përdorimi, kapaciteti, zgjerimi ose faktorë të tjerë të lidhur me projektin që me shume gjasa ndikojnë në nivelet e ardhshme të shpenzimeve kapitale.
 - Analizën e flukseve të tjera të parasë
 - interesat e pagueshëm dhe të arkëtueshëm;
 - tatimet; dhe
 - flukset financuese të parasë.

Pozicioni financiar

Analizën e aktiveve fikse

- Përmbledhje e pasurive të rëndësishme fikse të shoqërive duke përfshirë informacionin për vjetërsinë, jetën e mbetur për operim (asetet fikse se për sa kohë /vite mund të përdoren, sa kohë i ka mbetur për tu shfrytëzuar), koston, amortizimin e akumuluar, vlerën konatabël etj.;

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

- Komente mbi politikën e aplikuar të kontabilitetit për matjen e politikës së amortizimit/politikës së kapitalizimit;
- Komente mbi pronësinë/transferimin e pronësisë së pasurive fikse gjatë periudhës së analizuar;
- Bazuar në kërkesat e drejtuesve të shoqërive të bëhen komente mbi pasuritë fikse të tepërta, të vjetëruara, të dëmtuara, në fund të periudhës aktuale;
- Analiza mbi shpenzimet kapitale dhe kostot e mirëmbajtjes:
- të jepet një pasqyrë e shpenzimeve kapitale të kaluara, të planifikuara dhe të kryera sipas kategorive;
- Analizë për pasuritë fikse të lëna peng deri në datën e fundit në dispozicion dhe gjithashtu nëse ka ndonjë kufizim në lidhje me shitjen e ndonjë prone.

Inventari

- Analizën e vjetërsisë së inventarit në fund të periudhës aktuale dhe bërja e komenteve mbi inventarin e ngadaltë, të tepërt, dhe të vjetëruar dhe politikën përkatëse të sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme

- Përmbledhja e pozicionit të debitorëve të tregtisë në datën më të fundit të disponueshme duke theksuar vjetërsinë dhe sigurimin;
- Komentet mbi pikëpamjet e drejtuesve në lidhje me rikuperueshmërinë e borxheve të mëdha dhe/ose të vjetra tregtare të pazgjdhura.

Llogaritë e pagueshme

- Përmbledhje dhe komente për përbërjen dhe vjetërsinë e bilancit të kreditorëve tregtarë në datën më të fundit të vënë në dispozicion dhe komentet për pikëpamjet e drejtuesve të shoqërive mbi kushtet e pagesës dhe limitet e kredisë.

Artikuj të tjerë të kapitalit të punës

- Përmbledhje dhe komente mbi debitorët dhe kreditorët e tjerë në datën e fundit të disponueshme;
- Përmbledhje për elementët e kapitalit të punës në datën më të fundit të vënë në dispozicion që mund të kenë natyrën dhe mund të klasifikohen si borxh neto.

Borxhi neto

- Analiza mbi burimet e financimit dhe profilin historik të huamarrjes për periudhën e analizuar, nëse ka;

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

- Përmbledhja dhe komentet mbi kushtet (normën e interesit, kolateralin, kohën e ripagimit, etj) dhe bilancet e huave afatshkurtra dhe afatgjata, qirave financiare dhe marrëveshjeve të marrjes me qira, nëse ka;

- përmbledhja dhe analiza mbi bilancet e parasë për të dhënat më të fundit në dispozicion për YTD2018.

Detyrimet kontigjente dhe zërat jashtë bilancit

- Identifikimi, përcaktimi i angazhimeve të tjera dhe detyrimeve të kushtëzuara të synimit të përfshirë por pa u kufizuar në të;

- detyrimet e qirasë, kontratat e shitjes dhe blerjes, çështjet mjedisore, garancitë që u ofrohen palëve të treta, programet e shpenzimeve kapitale, garancitë, grantet, donacionet, subvencionet etj.

ANALIZA TATIMORE

- Shqyrtimi i strukturës tatimore të shoqërive.
- Shqyrtimi i pajtueshmërisë së shoqërive, me përgjegjësitë e detyrimet tatimore.
- Shqyrtimi i procedurave të raportimit tatimor dhe komente mbi efikasitetin e këtyre procedurave në praktikë.
- Shqyrtimi i regjistrave të kontrolleve tatimore të kryera dhe vendimet përkatëse të organeve tatimore. Komente mbi gjetjet kryesore dhe vlerësimet tatimore. Analizë e situatës aktuale të apelimeve administrative e gjyqësore, kundrejt vlerësimeve tatimore.

➤ **Tatimet e veçanta:**

○ *Tatimi mbi fitimin:*

- Shqyrtimi i situatës së tatimit mbi fitimin. Komente mbi humbjet tatimore (nëse ka), vitet në të cilat janë krijuar dhe vitet në të cilat mund të përdoren.
- Komente për të gjitha pagesat materiale të tatimit mbi fitimin (duke përfshirë parapagimet e tatimit mbi fitimin), shpenzimet aktuale tatimore dhe balancat tatimore të pagueshme/të arkëtueshme të tatimit mbi fitimin në datat përkatëse të bilancit.
- Rishikim i regjistrit të aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe i planit të amortizimit të tyre.
- Rishikim i pajtueshmërisë me detyrimet e raportimit dhe pagesës lidhur me tatimin mbi fitimin (këstet e parapagimit, deklarata vjetore, pasqyrat financiare, raporti i auditimit etj.).

○ *Tatimi në burim:*

- Shqyrtimi i transaksioneve më tipike e më të rëndësishme. Komente mbi llogaritjen e tatimit në burim.
- Rishikim i pajtueshmërisë me detyrimet e raportimit dhe pagesës lidhur me tatimin në burim (deklarata mujore).

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

- *TVSH:*
 - Verifikimi nëse trajtimi i TVSH-së për transaksionet më tipike e më të rëndësishme të shoqërive është në përputhje me legjislacionin shqiptar për TVSH-në.
 - Vlerësimi i mënyrës së llogaritjes dhe zbatimit të kreditimit të pjesëm të TVSH- së në blerje, nëse ka, si dhe i rregullimit të TVSH-së së kredituar në blerje për aktive materiale të nxjerra jashtë përdorimit.
 - Rishikim i pajtueshmërisë me detyrimet e raportimit dhe pagesës lidhur me TVSH- në (librat mujorë të blerjeve e të shitjeve, deklarata mujore).

- *Tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore:*
 - Shqyrtimi, mbi bazë përzgjedhje, i metodës së llogaritjes së pagës bruto për efekte tatimore, përfshirë trajtimin e shpërblimeve në natyrë e në forma të tjera, si dhe i metodës së llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
 - Rishikim i pajtueshmërisë me detyrimet e raportimit dhe pagesës lidhur me listëpagesat, tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore (deklarata mujore).

- *Taksa të tjera:*
 - Shqyrtimi i llogaritjeve dhe pagesave të taksave të tjera të aplikueshme, veçanërisht tatimin mbi pasurinë e paluajtshme (nëse janë të aplikueshme).

ANALIZA LIGJORE

Duke marrë në konsideratë nevojat dhe qëllimin e realizimit të këtij shërbimit, analiza ligjore duhet të mbulojë aspektet e mëposhtme:

- Shqyrtimi dhe analiza e ligjeve, vendimeve, rregulloreve dhe akteve të brendshme të bashkisë që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Shoqërive Aksionare.
- Analizë ligjore dhe përmbledhje mbi kontratat efektive të nënshkruara nga shoqëritë.
- Analiza ligjore e kontratave të përqëndrohet në objektin e kontratës, vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë, afatet, dispozitat e përfundimit, klauzolat e pavolitshme, mundësitë për zgjatjen e afatit, ekskluzivitetin etj.
- Përmbledhje mbi numrin e punonjësve dhe llojeve të kontratave të përdorura nga shoqëritë, pajtueshmëria e kontratave të punës me aktet/rregulloret që rregullojnë marrëdhëniet me punonjësit.
- Përgatitje e një përmbledhje e proceseve gjyqësore tregtare, administrative dhe të punësimit duke përfshirë: një përshkrim të cdo mosmarrveshjeve, objektin, palët e përfshira, autoritetin, vlerën e padisë, statusi i mosmarrveshjes, aktet e nxjerra nga autoriteti, zgjidhja, vendimet.

REKOMANDIME

Bazuar në analizën e zhvilluar dhe takimet e kryera, operatori ekonomik do të kompletojë gjetjet kryesore dhe do të përgatisë draf-raportet me gjetjet dhe rekomandimet kyce. Pas marrjes së reagimeve nga ekipi menaxhues do të përgatisë Raportin Përfundimtar dhe Rekomandimet. Operatori ekonomik do të propozojë rekomandimet përfundimtare për ndryshimet në praktikat, procedurat dhe modelet e dokumentave që do të zbatohen nga Shoqëritë si dhe ndryshimet organizative duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- Rekomandime për metodën e kontabilitetit të aplikuar për vlerat e pronës, impjanteve dhe paisjeve;
- Rekomandime për mënyrën e mbledhjes/shlyerjes së llogarive të arkëtueshme të Shoqërive;
- Rekomandime për mekanizmat e rregullimit të borxhit;
- Rekomandime për mekanizmin për sisteminim dhe /ose mbulimin e humbjeve të akumuluarra të Shoqërive;
- Alternativa për zgjidhjen e çështjeve pronësore;
- Forma e riorganizimit dhe procedura ligjore për zbatimin e saj, si dhe asistencë në përgatitjen e drafteve të akteve përkatëse.

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve do të jetë: Bashkia Tiranë

Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit³.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5 ;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 11, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 12.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin e Audituesve Ligjorë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2019, 2020) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

³ Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e shërbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekspertizat e marra përsipër për tu realizuar.

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

2.2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2018, 2019, 2020) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka në dispozicion burime njerëzore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të kontratës.

a) Për përmbushjen e këtij kriteri, numri mesatar i të punësuarve duhet të jetë jo më pak se 5 (pesë), vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore (e-Sig02/a) ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B.
- b. Listëpagesat sipas formularit eSig25 për muajin e fundit të deklaruar sipas legjislacionit në fuqi, nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B.

b) Konsulenti duhet të ketë në përbërje staf pune të kualifikuar për hartimin e studimit/ raportit/ vlerësimit financiar- Juridik për riorganizimin e shoqërive. Operatori ekonomik duhet të ketë një Ekip të përbërë nga Ekspertë me eksperiencë të ngjashme në fushat respektive të ekspertizës, si më poshtë:

b-1) 1 (një) Ekspert kryesor/ Menaxher projekti të diplomuar në nivel Master në fushat e ngjashme me shërbimet e kërkuara si, ekonomi apo agro-biznes, apo ndonje fushë tjetër e ngjashme me to. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë pune, me njohuri dhe eksperiencë të mëparshme në nivel menaxherial në koordinim dhe implementim projektsh. Të ketë njohuri të mira të organeve të qeverisjes vendore.

“Vlerësim Financiar dhe konsulencë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

b-2) 2 (dy) Ekspertë Ligjorë të diplomuar në nivel Master në drejtësi. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë profesionale në fushën e të drejtës tregtare, si krijimi dhe funksionimi i shoqërive, shkrirja dhe bashkimi etj.

b-3) 2 (dy) Ekspertë Kontabël të diplomuar në nivel Master në Ekonomi, Financë ose në ndonjë fushë tjetër të ngjashme. Të ketë të paktën 7 (shtatë) vjet eksperiencë profesionale, të tilla si, në hartimin dhe auditimin e bilanceve, pasqyrave financiare etj., të ngjashme me to. Të zotërojnë liçencën e Audituesit Ligjor lëshuar nga IEKA për kryerjen dhe ofrimin e shërbimeve financiare.

Për të vërtetuar kualifikimet, eksperiencën e punës dhe profilet e stafit/ ekipit të ekspertëve si më sipër, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin justifikues, si më poshtë:

- ✓ Deklarimin nga Operatori Ekonomik të profilit të punonjësit
- ✓ CV
- ✓ Librezë pune
- ✓ Diplomë në fushat përkatëse të kërkuar
- ✓ Liçencë për ekspertët e Kontabël
- ✓ Kontratë pune/ angazhimi të vlefshme

Në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.12, pjesa III, pika B, ku të deklarohet disponimi dhe profili i punonjësve të sipërcituar.

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulencë”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, bëjmë me dije që OE të mbajnë në konsideratë se autoriteti/enti kontraktor i kërkon OE të kualifikuar në fazën e parë (Lista e shkurtër), të dorëzojnë dokumentacionin provues, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Shtojca 12

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin
--

“Vlerësim Financiar dhe konsulentë Juridike me qëllim riorganizimin e 2 Sha-ve”

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet për t’u nënkontraktuar

